

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 01.07.2024, regjistruar në datën 02.07.2024, ju bëjmë me dije se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 20, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Në vijim të kërkesës suaj ju sqarojmë si vijon:

Së pari, procedura e konkurrimit me kodin e shpalljes 6257- *Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri -klasa e pagës II-1* është shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike (DAP), në zbatim të VKM-së nr. 62, datë 07.02.2024 "*Për planin vjetor të pranimi në vitin 2024 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil*", të VKM-së nr.255, datë 24.04.2024 "*Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2024*". Pika 4, e nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar parashikon se përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.

Në respektim të nenit 20, të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, DAP ka zhvilluar procedurën e konkurrimit, bazuar në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar.

Bazuar në VKM-në nr. 242/2015 të Këshillit të Ministrave "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*", të ndryshuar, konkurrimi përfshin dy faza: verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe vlerësimin e kandidatëve.

Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet nga Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), i cili ngrihet me urdhër të njësisë përgjegjëse (DAP) dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) 2 (dy) anëtar nga institucioni që ka vendin vakant.
- c) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse. Në rast pamundësie të pjesëmarrjes së anëtarëve të KPND-së, njësia përgjegjëse merr masa për zëvendësimin e tyre.

Ekspertët zgjidhen nga njësia përgjegjëse, duke patur në konsideratë karakteristikat e pozicionit, për të cilin do të zhvillohet procedura e konkurrimit. Ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e

licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion.

Sqarojmë se KPND është organ kolegjal, dhe vlerësimi i bërë nga anëtarët e KPND-së është një akt diskrecionar i këtij të fundit. Për vlerësimin e rezultateve për secilin kandidat, secili prej anëtarëve të KPND jep pikët e tij. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen: a) vlerësimi i jetëshkrimit i cili bëhet sipas Udhëzimit nr.2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur” të DAP; b) vlerësimi në testimin me shkrim i cili është i konceptuar me 20 pyetje me alternativa, ku për secilën pyetje vetëm njëra nga alternativat është përgjigja e saktë. Korrigjimi i testeve nuk realizohet manualisht nga Komiteti, por nga sistemi kompjuterik, i cili gjeneron rezultatin për çdo kandidat referuar celsit të përgjigjësve të sakta për secilën pyetje të hartuar nga Komiteti. c) Vlerësimi në intervistën e strukturuar me gojë. KPND i harton pyetjet e intervistës së strukturuar me gojë duke iu referuar fushës ligjore të përcaktuar në shpalljen, me qëllimin për të vlerësuar njohuritë që kandidatët zotërojnë si dhe ato të përfituara nga eksperiencat e tyre. Diskrecioni i Komitetit materializohet në përzgjedhjen e pyetjeve konkrete që bëhen gjatë intervistës së strukturuar me gojë. KPND-ja, ditën e intervistës së strukturuar me gojë, zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët pjesëmarrës. Pjesë e diskrecionit të KPND është edhe përcaktimi i përgjigjes së saktë për çdo pyetje të shtruar kandidatit, po ashtu edhe vlerësimi i bërë në pikë konkrete për secilën përgjigje të dhënë nga kandidati.

Në përfundim pikët e grumbulluara për secilën fazë mbledhen dhe pjesëtohen me 5, duke i rrumbullakosur deri në një presje dhjetore. Rezultati përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.

Qendrimi i mësipërm, mbështetet në vendimin nr. 00-2022-3972 (436), datë 20.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ndër të tjerat është shprehur se “18. ... *Konsistenca e përgjigjes së dhënë në raport me hapësirat e vëna në dispozicion në tezën e testimit, mendimi subjektiv i konkurentit mbi kuptimin e ligjit, marzhi i vlerësimit të pyetjeve në raport me përgjigjen e dhënë, janë pa asnjë dyshim pjesë diskrecionare dhe ekskluzive e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të cilat nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit gjyqësor*”.

Lidhur me vënien në dispozicion të pikëve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë procedurë për secilin element (testimit me shkrim, intervistës së strukturuar me gojë dhe dosjes), si edhe të dokumentacionit vlerësues që Komiteti ka bërë për këta kandidatë, sqarojmë se administrohen nga njësia përgjegjëse dhe KPND në raportin e vlerësimit, në funksion të mbarëvajtjes së procedurës administrative.

Në vijim të arsytimit lidhur me këtë aspekt, ato përbëjnë të dhëna personale, e në këtë kuptim, gjen zbatim parimi i mbrojtjes së të dhënave të kandidatëve, parashikuar në nenet 9 dhe 45, pika 3, të KPA, nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si edhe nga neni 17, i ligjit nr.199/2014 “Për të drejtën e

informimit” i ndryshuar, ku parashikohen kufizime të qarta lidhur me përcjelljen e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale,

Konsiderimi i këtyre të informacioneve si të dhëna personale, bazohet edhe në vendimin e sipërcituar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili duke iu referuar Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen “Peter Nowak kundër Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, dhjetor 2017”, është shprehur se *“24. GJED ka vlerësuar se, së pari, përmbajtja e këtyre përgjigjeve pasqyron shkallën e njohurive dhe kompetencës së kandidatit në një fushë të caktuar dhe, në disa raste, intelektin, proceset e të menduarit dhe gjykimin e tij. Në rastin e një shkrimi të shkruar me dorë, përgjigjet përmbajnë, përveç kësaj, informacion për shkrimin e tij. Së dyti, qëllimi i mbledhjes së këtyre përgjigjeve është të vlerësohet aftësia profesionale e kandidatit dhe përshtatshmëria e tij për të ushtruar profesionin në fjalë. (prg. 37-38). Lidhur me komentet e ekzaminuesit për përgjigjet e kandidatit është e qartë se ato përbëjnë informacion në lidhje me atë kandidat. Gjykata ka konkluduar se përgjigjet me shkrim të kandidatëve në një ekzaminim profesional dhe komentet e bëra nga korrigjuesi në lidhje me këto përgjigje, përbën të dhënë personale të kuptim të Direktivës, për të cilat kërkuesi ka në parim të drejtën e aksesit. (prg. 62). Gjykata ka çmuar se është e padiskutueshme që një kandidat ka ndër të tjera interes të ligjshëm bazuar në mbrojtjen e jetës së tij private, për të qenë në gjendje të kundërshtoj përpunimin e të dhënave mbi përgjigjet e tij në provim dhe komenteve të korrigjuesit mbi to jashtë procedurës së konkurimit dhe në veçanti dërgimin e tyre palëve të treta ose publikimin pa lejen e tij. Po kështu, organi që bën ekzaminimin, si kontrollues i të dhënave, është i detyruar të sigurojë që ato përgjigje dhe komente të ruhen në mënyrë të tillë që të sigurohet që palët e treta të mos kenë akses të paligjshëm në to. (prg. 50)”*.

Nga arsyetimi i mësipërm, i autoritetit më të lartë gjyqësor në vend, rezulton qartësisht se testimet e kandidatëve të tjerë, si edhe vlerësimi që Komisioni ka dhënë për përgjigjet e kandidatëve të ndryshëm, konsiderohen si të dhëna personale, shpërndarja e të cilave është e kufizuar.

Në përfundim, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, konstaton se procedura e konkurimit për pozicionin me kod 6257 *Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri -klasa e pagës II-1* është zhvilluar në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 242/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar.

Në përfundim të fazës së ankimimit, bazuar në pikën 32 dhe 33 të kreut III të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, vendosi përfundimin e procedurës me kod 6257 *Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri -klasa e pagës II-1*, pa kandidat fitues. (bashkëlidhur linku i njoftimit të përfundimit të procedurës pa kandidat fitues në faqen zyrtare nga DAP)

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4864/4/14>

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4864/5/17>

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.